

ZYRA PËR INFORMIM

Zyra për Informim, gjatë periudhës raportuese, janar-qershor 2025, ka vazhduar me përcjelljen e aktiviteteve ditore të Komunës së Rahovecit. Përmes vegëzës zyrtare: <https://rahovec.rks-gov.net/>

Në webfaqen e Komunës janë publikuar të gjitha aktivitetet e mbajtura dhe janë publikuar të gjitha vendimet, raportet, njoftimet, konkurset dhe dokumente tjera në interes të gjithë qytetarëve të Komunës. Ka mbajtur kontakte të rregullta me media, ku i ka përcjellur njoftime e lajme ditore për aktivitetet e zhvilluara në Komunë, ftesa etj.

Gjatë muajve janar- qershor 2025 janë publikuar: aktivitete-dokumente, detajet mund t'i shihni në tabelën e mëposhtme:

Lajme	Njoftime	Dok financiare	Thirrje	Konkurse	Plane	Takime/Dë gjime Konsultime	Raporte	Vendimet e Kryetarit	Aktivitete gjithsej
150	40	6	12	10	2	8	24	303	555

Të gjitha vendimet e nënshkruara nga kryetari i komunës gjatë kësaj periudhe raportuese janë dërguar tek zyrtarët përkatës në MAPL dhe janë publikuar në web faqen zyrtare të komunës. Për këtë periudhë raportuese, kryetari ka nënshkruar 303 vendime.

Është bërë plotësimi i dokumenteve-raporteve si nga ministritë edhe nga OJQ-të e që kanë pasur të bënin me transparencë, performancë dhe llogaridhënie komunale.